



MINISTRIA E EUROPËS DHE PUNËVE TË JASHTME  
AMBASADA E FRANCËS NË KOSOVË  
*Departamenti për bashkëpunim dhe veprimtari kulturore*

## Thirrje për aplikim : bursa universitare në Francë

### Bursa të Qeverisë së Francës 2023

Ambasada e Francës në Kosovë ofron këtë vit bursa universitare të nivelit Master për studentë kosovarë të cilët dëshirojnë të ndjekin studime në Francë.

Do të trajtohen me kujdes të shtuar dosjet e aplikimit nga fushat në vijim:

- shkencat natyrore: kimi, fizikë, matematikë, biologji si dhe,
- bujqësi dhe mjedis.

Dosja për aplikim i dërgohet Departamentit për bashkëpunim dhe veprimtari kulturore dhe duhet të përmbajë : një CV, letrën motivuese, kopjen e diplomës së fundit me transkriptin e notave si dhe dëshminë e të qenit në kontakt apo pararegjistrimin në një universitet francez.

Dosja juaj mund të përmbajë poashtu një letër rekomandimi nga një nga profesorët ose nga shefi i departamentit.

Perparësi kanë dosjet e studentëve të cilët kanë njohuri në gjuhë frënge të nivelit B1 /B2 ose shfaqin interes për mësimin e gjuhës frënge.

Afati i fundit për dorëzimin e dosjeve është **data 12 qershor 2023**.

Kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë në Ambasadën e Francës gjatë muajit qershor 2023.

Dosjet duhet dërguar në e-mail adresën në vijim : [scac.pristina-amba@diplomatie.gouv.fr](mailto:scac.pristina-amba@diplomatie.gouv.fr)

Për informata shtesë rreth studimeve në Francë:

- Ambasada e Francës në Kosovë : <https://kosovo.ambafrance.org/-Etudier-en-France-311->
- Espace *Campus France* në Aleancën Franceze në Prishtinë : [campusfrance@af-pristina.com](mailto:campusfrance@af-pristina.com)
- Web faqe rreth studimeve në Francë : <https://www.campusfrance.org/fr/sejour-universitaire-France>